



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 15573 Prot

Vlorë, më: 13 . 12 , 2023

DËGJESË PUBLIKE

MBI NDRYSHIMIN E NIVELIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E UJIT TË
PIJSHËM DHE LARGIMIN DHE PËRPUNIMIN E UJRAVE TË NDOTURA

Data 17.11.2023: ora 13.00

Vendi: Pallati i Kulturës "Labëria"

Marin pjesë:

Ermal Dredha-Kryetari i Bashkisë Vlorë, Irena Toshkallari-nënkryetare e Bashkisë Vlorë,

Novruz Rrokaj-Nënkryetari i Këshillit Bashkiak, Anëtarë të KB, përfaqësues nga bizneset. shoqëri civile.

Dëgjesa u hap nga z.Ermal Dredha-Kryetari i Bashkisë Vlorë: Jemi nga Bashkitë që kemi tarifën më të ulët të ujit nga të gjitha qytetet.

Rajmonda: Ne jemi shoqëri tregtare me të ardhura dhe duhet të mbulojmë shpenzimet. Cmimet janë nën kosto. Gjithë veprimtaritë e rrisin punën mbi kostot.

2019-45 lek. Bashkia Vlorë, është më mbrapa në kosto. 117 l/m³ pra do bëhet 45 lekë/m³ për popullatën dhe 100 lekë/m³ për orivate dhe kostua për 1m³ të ardhur është 69 lekë/m³ jo për bizneset. (1 litër-116 lek) ujtë jellësi e kërkoi këtë rritje për të rritur kostot e shërbimit. Hyjnë këtu (emërimet pagat sig shoqërore) tarifat janë shumë të ulta dhe cmimi është nën kosto. Argumentat ekonomik I kemi dorëzuar.

Geron Gumbardhi: Kur erdhi përfaqësi AKUMI më tha e kemi personale. 1 miliard që ja kemi marrë në mënyrë të padrejtë Bashkisë Vlorë.

Investimi 12 ml Euro nga KM do të marrë dhe qytetarëve. A do ketë ujë të pijshëm? Bëni si fillim bilancin sa jae në punë ditën e hënë.

Rajmonda: 398, 5000 m³ ka rrjedhje si në hyrje dhe në dalje, kemi humbje të dyfishta. Biznesi paguan sa një familjar. Investimet janë bërë do bëhen do rritet cilësinë e ujit.

Geron Gumbardhi. Lagja Partizani janë pa ujë.

Rajmonda: Se kam problem politik. Punëtorët janë të gjithë në punë.

Geron Gumbardhi: Abonentët e paligjshëm i keni prerë.

Alketa: Si është procedura, pra rritja e cmimit nga AKUMI kalon ne Këshillin Bashkiak. Tani kjo është dëgjese publike.

Daut Zeraj: kjo është për Këshillin Bashkiak.

Ermal Dredha: Shumë faleminderit!

(Bashkangjitur argumentimi)

Hartoi: Sp. Albana Naçi



Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Argumentin për takimin e datës 17/11/2023

Ujësjetës kanalizime Vlorë është një shoqëri tregtare që ka aktivitet prodhim dhe shitje uji, dhe shërbimin e largimit të ujerave të ndotura.

Si çdo biznes i cili ka një aktivitet, shërbimi, blerje-shitje etj para se të fillojë aktivitetin bën një analizë të kostos për mallrat që do të shesë apo për shërbimin që do të shesë.

dhe në analizën e kostos ai përfshin të gjithë elementet e shpenzimeve që do të duhen që këtë produkt apo shërbim ta shesë dhe të krijojë të ardhura për vazhdimin e aktivitetit, dhe këtë kosto do ta ndërtojë duke shtuar dhe një normë fitimi, nuk do ta shesë produktin apo shërbimin në kosto, se kjo nuk do ta lejonte të vazhdonte aktivitetin.

Ujësjetës kanalizime Vlorë prodhon dhe shet uji për abonentët Familjare, Privat e Buxhet, dhe çmimi i shitjes është në koston e prodhimit dhe të shitjes. Në koston e shitjes në nuk mund të përballojmë vlerën e shpenzimeve që janë domosdoshmëri për dërgimin e ujit në abonentët tanë.

Në çmimi aktual për shitjen e ujit për vitin 2022 të ardhurat e realizuara në total janë 345,516,100 leke 73% janë nga popullata, 19% janë nga privati dhe 8% nga buxheti.

Argumentimin e propozimit për ndryshimin e tarifave po e nis nga fundi

- në të gjithë kur pimë kafe marrin dhe një shishe uji me volum 0,5 L të cilën e marrim 80 leke, volumin ta konvertojmë në m³ është 0.0005 m³, që do të thotë 0,0005 m³ e blejmë për 80 leke dhe një liter ujë e blejmë 160 leke.

në si shoqëri tregtare, si gjithë bizneset nuk punojnë pa fitim, ndërsa UK Vlorë koston për 1 Liter ujë e ka kosto për 1m³ ujë të faturuar në abonentë është 117 leke/m³, ndërsa të ardhurat nga aktiviteti të shitjes së ujit sigurohen nga çmimet aktuale. për popullatën 45 leke /m³ dhe 100 leke/m³ për private dhe buxhetë dhe kostua për 1m³ të ardhur është 69 leke/m³.

Diferenca aktuale e kostos së shërbimit çmimit për abonentë popullatë është 72 leke/m³ dhe diferenca (kosto-çmimi) për privatet është 17 leke/m³.

2-kosto për 1m³ ujë të ndotur, të larguar, të faturuar është 45 leke/m³, dhe të ardhurat të aktivitetit i largimit të ujerave të ndotura është 15 leke/m³ të faturuar. Çmimi për 1m³ për popullatën është 15 leke /m³ për popullatën dhe 25 leke/m³ për abonentë private e buxhet.

- *Diferenca aktuale e kostos së shërbimit çmimit për abonentë popullatë është 30 leke/m³ dhe diferenca (kosto-çmimi) për privatet është 20 leke/m³.*

Efektet e ndryshimit të tarifës për popullatën për të dy shërbimet në faturën e ujit do të jenë:

- Fatura Mujore për Klientët Familjarë Bashkinë Vlorë, ku janë të përfshira dhe njesite Administrative janë:
- Me cmimin aktual
- Fatura aktuale: $12 \text{ m}^3 * 45 \text{ lekë (Uji)}$
 $12 \text{ m}^3 * 15 \text{ lekë (kanalizime)} = 720 \text{ lekë}$
- Me cmimi e propozuar për ndryshim
- Fatura e propozuar: $12 \text{ m}^3 * 60 \text{ lekë (Uji)}$
 $12 \text{ m}^3 * 17 \text{ lekë (kanalizime)} = 924 \text{ lekë}$
- Rritja në vlerë për një faturë familjare me konsum mesatar 12 m^3 është 204 lekë.